



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2126/110 Prot.

Tiranë, më 16.09 2025

VENDIM
Nr. 102 datë 16.09 2025

PËR
NËNSHKRIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT
ME PREMIUM CLINIC (CENTRAL PHARMA GROUP SHPK)


Mbështetur në nenin 3, pika 4, gërma “c” dhe nenin 38 të Ligjit nr. 80/2015 ‘Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë’, në nenin 20, pika “s” të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës si dhe në **Vendimin e Rektoratit nr. 99 datë 11/09/2025**, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës **16/09/2025**,

V E N D O S I:

1. Miratimin e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet **Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe Premium Clinic (Central Pharma Group shpk)**.
2. Ky Vendim i përcillet Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim në faqen zyrtare të institucionit.
3. Ngarkohet për zbatimin dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nënshkrimit Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë, Publikun dhe Studentët.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT

Prof.Dr. AGRON KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I SPORTEVE
TË TIRANËS**

Nr.....prot
Datë _____ 2025

PREMIUM CLINIC

Nr.....prot
Datë _____ 2025

**draft
MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET
UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS
DHE
PREMIUM CLINIC (CENTRAL PHARMA GROUP SHPK)**

E lidhur sot më datë _____._____.2025 ndërmjet:

UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS, me NIPT K51712019Q, me adresë Rruga “Muhamet Gjollesha”, Tiranë, përfaqësuar nga **Rektori Prof.Dr. Agron KASA** këtu e më poshtë **UST**

dhe

PREMIUM CLINIC (CENTRAL PHARMA GROUP SHPK), me NUIS M02114010E, me adresë Rruga e Kosovareve, Tiranë, përfaqësuar nga **z. Hysen Dika** këtu e më poshtë **PC**

Palët bien dakord si më poshtë:

**Neni 1
Objekti**

Objekt i kësaj Marrëveshje është bashkëpunimi mbi bazen e barazisë dhe përfitimit reciprok në fushën e rehabilitimit, mjekësisë sportive, kontrollit mjekësor bazë, edukimit shëndetësor, projekteve të përbashkëta dhe më gjerë.

**Neni 2
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi mes dy subjekteve për realizimin e veprimtarive të përbashkëta informuese dhe promovuese, me qëllim evidentimin dhe zgjidhjen e problematikave, rritjen e imazhit të institucioneve respektive si dhe

- Angazhohet në ofrimin e ekspertizës për të realizuar aplikime në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare me interes të përbashkët të dy institucioneve që përfshin fushat e veprimit ku ato zhvillojnë veprimtarinë e tyre.

Neni 6

Autoriteti dhe afati i zbatimit

Autoritetin për të zbatuar këtë marrëveshje e ka **Universiteti i Sporteve të Tiranës** dhe **Premium Clinic** Kjo marrëveshje është për një afat të papërcaktuar.

Neni 7

Mirëkuptimi dhe vullneti për bashkëpunim

1. **Universiteti i Sporteve të Tiranës** dhe **Premium Clinic**.
2. shprehin mirëkuptimin dhe vullnetin për një bashkëpunim të frytshëm dhe rezultativ.
3. Ngarkohen strukturat përkatëse të **Universitetit dhe Klinikës** për hartimin e planeve të përbashkëta për realizimin e angazhimeve të palëve.

Neni 8

Nënshkrimi

Kjo Marrëveshje e lidhur midis **Universitetit i Sporteve të Tiranës** dhe **Premium Clinic** mbahet në 2 (dy) kopje origjinale dhe ka fuqi zbatuese nga punonjësit e tyre.

Marrëveshja përbëhet nga tre fletë dhe secila prej tyre nënshkruhet nga titullarët e institucioneve.

Vendi dhe data e nënshkrimit

Tiranë më : .../09/2025

PËR
UNIVERSITETIN E SPORTEVE
TË TIRANËS

REKTORI
Prof. Dr. Agron KASA

PËR
PREMIUM CLINIC

ADMINISTRATORI
Z. Hysen DIKA